

Task Forca për Integrim Evropian e Kosovës

Përmbledhje Narrative

Konteksti i përgjithshëm:

Institucionet e Republikës së Kosovës mbetën të përkushtuara në zbatimin e agjendës evropiane, ndërsa kjo fuqizohet me pjesëmarrje formale të Kosovës në Procesin e Stabilizim-Asociimit, pas fillimit të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA) në vitin 2010. Në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Integritimit Evropian (MIE) po udhëheq këtë proces me vendosmëri. Ngjashëm dhe konform fushëveprimin të tyre, akterët të ndryshëm të shoqërisë dhe publiku e gjerë mbetën të përkushtuar dhe përkrahës të fuqishëm të integritimit të vendit në BE. Ky niveli i përkrahjes nga publiku i gjerë shënon një shkallë të përkrahjes nga më të lartat në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Pas nisjes zyrtare të *Procesit të Stabilizim-Asociimit*, në Samitin e Zagrebit, të vitit 2000, Kosova u bë pjesë e këtij procesi në fillim të vitit 2003. Në kuadër të këtij procesi deri më 2009 në nivel politik dhe teknik dialogu mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian është zhvilluar nëpërmes të ashtuquajturit 'Mekanizëm Përcjellës të Stabilizim-Asociimit' (MPSA). Por, për shkak të rrethanave komplekse nëpër të cilat ka kaluar Kosova gjatë tërë këtyre viteve, ky proces është përcjellë me vështirësi, duke i pamundësuar Kosovës dhe BE-së të vendosin marrëdhënie kontraktuale. Për pasojë, marrëdhëniet Kosovë - BE deri më tani kanë mbetur kryesisht të natyrës politike. Në terma konkret këto marrëdhënie janë formësuar nëpërmes *Partneritetin Evropian për Kosovën*, i cili ishte nxjerrë për herë të parë më 2004, dhe i përditësuar dy herë: më 2006 dhe 2008.

Sipas referencave zyrtare, dhe veçmas Raportit të Progresit të Bashkimit Evropian, pas Shpalljes së Pavarësisë dhe njohjes së saj nga shumica e shteteve anëtare të BE, Kosova ka shënuar progres në fushën politike, në reforma institucionale, ekonomike e sociale. Megjithatë, akoma mbetin sfida të shumta, në veçanti sa i përket: zbatimin të ligjit; reformimin të administratës publike; luftimin të korrupsionit; krijimin e një ekonomie funksionale të tregut e cila do të kishte potencial që t'i rezistojë presionit konkurrues dhe forcave të tregut, gjendja në pjesën veriore të vendit. Për shkak të qasjes jo konstruktive të disa vendeve fqinje, Kosova ka hasur në pengesa dhe vështirësi në pjesëmarrjen në nisma rajonale. Në masë të caktuar kjo ka vonuar Kosovën që të arrijë vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale funksionale me BE-në, përfshirë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Në anën tjetër, pas progresit të konsiderueshëm të shënuar në fushën e riadhesimit dhe ri-integritimit të shtetasve kosovarë të riadhesuar, në janar 2012, Komisioni Evropian ka nisur dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën, i cili pritet të rezultojë në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave kah fundi i pranverës, ndërsa aktualisht Bashkimi Evropian i ka ofruar Kosovës Studimi i Fizibilitetit, i cili pritet të përfundojë brenda vitit 2012.

Si përgjigje ndaj Partneritetit Evropian për Kosovën, më 2005, Qeveria e Kosovës ka miratuar *Planin e parë të Veprimit për Zbatimin e Partneritetit Evropian (PVPE)*. Me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuar nga KE në kuadër të Raportëve vjetore të Progresit për Kosovën, PVPE vazhdon të përditësohet në fund të çdo viti, ndërsa kjo bëhet nën koordinimin e MIE, dhe me pjesëmarrje të gjerë të institucioneve të Kosovës: Kuvendit, Qeverisë, autoriteteve lokale,

institucioneve të pavarura e kështu me radhë. PVPE gjithashtu reflekton gjetjet dhe vlerësimet e përbashkëta të dala nga takimet e rregullta plenare dhe sektoriale të DPSA-së. Me qëllim të avancimit të përgatitjes së institucioneve të Kosovës për zbatimin e agjendës evropiane, në prill 2008 Qeveria ka miratuar *Planin për Integrim Evropian 2008 - 2010*, i cili paraqiste një paketë reformuese të kornizës institucionale përgjegjëse për integrim evropian. Si pjesë e këtyre reformave, janë themeluar dhe funksionojnë strukturat koordinuese në tri nivele: gjashtë *Komitete Ekzekutive* sektoriale (paraprakisht *Grupe Punuese*) të nivelit teknik, një *Komitet Punues për Integrim Evropian*, në nivel menaxherial, dhe një *Këshill Ministror për Integrim Evropian*, në nivel politik.

Në prill, 2010 Kosova themeloi *Ministrinë e Integritimit Evropian - MIE*, ndërsa me 2011 Qeveria miratoi një rregullore me anë të së cilës Zyrat për Integrim Evropian në ministritë e linjës u avancuan në Departamente për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave. Një vështirësi e radhës është koordinimi i një numri kompleks dhe të shumëllojshëm të çështjeve që lidhen me integrim evropian dhe institucioneve të përfshira, por gjithashtu të shumë akterëve jo-qeveritarë dhe palëve të tjera të interesuara. Ekziston nevoja për krijimin e një mekanizmi të thjeshtë dhe efektiv i cili do t'u mundësonte institucioneve shtetërore, përmes MIE, një nivel më të lartë dhe më efikas të koordinimit. Ky mekanizëm shmang krijimin e një strukture formale permanente, gjë që do të komplikonte më tej procesin e integritimit evropian.

Këshilli Nacional për Integrim Evropian:

Këto zhvillime dhe kërkesa konkrete në lidhje me procesin e integritimit evropian kanë rezultuar me nismën e institucionit të Presidentit të Republikës që të angazhohet në krijimin e një mekanizmi nacional për integrim evropian, përkatësisht *Këshilli Nacional për Integrim Evropian (KNIE)*. Ky Këshill, i themeluar më 27 mars 2012, nga Presidentja e Republikës, në prani edhe të Komisionarit të BE-së për Politika të Zgjerimit dhe Fqinjësisë, Štefan Füle, do të shërbejë si platformë zyrtare nacionale për forcimin e koordinimit politik dhe konsultime të rregullta e sistematike në mes të akterëve kryesorë, përfshirë Qeverinë, Kuvendin, partitë politike, komunitat, shoqërinë civile, institucionet akademike dhe komunitetin e biznesit, dhe palë të tjera të interesuara. Pavarësisht nga zhvillimet dhe ndryshimet e tjera të mundshme politike në institucionet qendrore dhe në cilindo nivel, kjo qasje pritet të sigurojë një kurs të qartë dhe stabil të integritimit evropian. KNIE do të takohet në baza vjetore për të vlerësuar përparimin e vendit drejt integritimit në BE, për të identifikuar, për t'u pajtuar mbi hapat e ardhshëm që duhet të ndërmerren në këtë proces si dhe për të dhënë rekomandimet përkatëse për akterët përgjegjës.

Task Forca për Integrim Evropian:

Domosdoshmëria për përshtetimin e punëve praktike dhe formësimit të një konsensusi mbarë-kombëtar në procesin e integritimit evropian ka bërë që KNIE të rekomandojë një mekanizëm të njohur si *Task Forcë për Integrim Evropian të Kosovës*. Kjo detyrë i është besuar Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Integritimit Evropian. Përgjegjësia e MIE-së është të themelojë, të përkrahë dhe ta udhëzojë *Task Forcën* sa u përket aspekteve teknike dhe të funksionit të tij, përfshirë sigurimin e grumbullimit të ekspertizës në të gjitha fushat specifike të politikave publike që kanë të bëjnë me përafrimin e politikave me ato të BE-së. *Task Forca* do të shërbejë si *mekanizëm* për zhvillimin e konsensusit mbi sfidat me të cilat përballlet Kosova në procesin e integritimit evropian dhe prioritetet e masat që duhet ndërmarrë për adresimin e tyre.

Objektivat e Task Forcës:

Objektivat e *Task Forcës* konsistojnë në përpilimin e *Raportit Diagnostikues* në lidhje me procesin e integrimit evropian. Së pari, *Raporti Diagnostikues* do të ngërthejë analiza të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse të përparimit të arritur deri më tani në të gjitha fushat e politikave publike në kuadër të kornizës së integrimit evropian si dhe do të identifikojë të gjitha sfidat në kuadër të secilës fushë. Gjithashtu *Task Forca* do të shërbejë si platformë për ndërtimin dhe mirëmbajtjes së konsensusit në mes të gjithë akterëve të përfshirë në secilën fushë mbi atë se çfarë duhet ndërmarrë për adresimin e sfidave të identifikuara. Sikurse është dëshmuar edhe në vende tjera në procesin e integrimit dhe anëtarësimit në BE. *Task Forca*, si mekanizëm, paraqet një formë të pazëvendësueshme për të mbajtur shkallën e lartë të përkrahjes së shoqërisë për integrim në BE, duke përdorur atë në dobi të përmirësimit të politikave dhe punës së institucioneve përgjegjëse në këtë proces.

Së dyti, *Task Forca* do të nxjerrë më pas në një *Strategjinë Nacionale për Integrim Evropian*. Ky do të jetë një dokument gjithëpërfshirës dhe do të përmbajë objektiva dhe aktivitete të qarta për tu arritur. Ai gjithashtu do të ofrojë një përshkrim më të qartës në lidhje me atë se çfarë, përse dhe kur duhet bërë, dhe atë në një formë të përkufizuar qartë, brenda afateve kohor realiste dhe të pranueshme nga të gjithë akterët e përfshirë. Kundrejt dimensionit formal të integrimit evropian, kjo *Strategji* do të reflektonte kritere cilësore: formulim preciz të objektivave; përkufizim të qartë të treguesve të progresit; identifikim të burimeve, si dhe të dhënave e informatave në shërbim të programimit, monitorimit dhe vlerësimit; pastaj përshkrimin dhe vlerësim më realist të supozimeve dhe rreziqeve gjatë zbatimit; përshkrim të hollësishëm të procedurave të vendimmarrjes dhe transparencës, propozime që kërkojnë masa të reja legislative, identifikimin e qartë të burimeve të financimit, referencën në konsultimet sociale, e të ngjashme.

Fushëveprimi i *Task Forcës*:

Dy dokumentet e sipërpërmendura – *Raporti Diagnostikues* dhe *Strategjia Nacionale për Integrim Evropian* – do të jenë rezultat i punës sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Kjo punë do të organizohet në kuadër të shtatë (7) fushave të politikave:

1. Reforma e Administratës Publike;
2. Drejtësia, Liria dhe Siguria;
3. Ekonomia, Financat dhe Statistikat;
4. Tregtia, Industria, Doganat, Tatimet, Tregu i Brendshëm, Konkurrenca, dhe Mbrojtja e Konsumatorit dhe ajo Shëndetësore;
5. Inovacioni, Shoqëria Informative, Politikat Sociale dhe ato Shëndetësore;
6. Transporti, Mjedisi, Energjia dhe Zhvillimi Rajonal, si dhe;
7. Bujqësia, Peshkataria, Pylltaria, Siguria e Ushqimit dhe Zhvillimi Rural.

Sekretariati i *Task Forcës*:

Sekretariati i është përgjegjës që të sigurojë organizimin e rrjedhshëm dhe efikas të aktiviteteve të *Task Forca*, dhe si i tillë është angazhohet për të gjitha çështjet teknike, operative dhe logjistike. Në shërbim të përgatitjeve dhe punës që do të rezultojnë me *Raportin Diagnostikues* dhe *Strategjinë Kombëtare për Integrim Evropian*, Sekretariati do të organizojë takime pune, seminare, konferenca dhe vizita studimore. Puna e Sekretariatit përkrahet nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe implementohet drejtpërdrejt nga Agjencia Gjermane për

Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, GIZ), në kuadër të projektit të saj *Mbështetje Procesit të Integritimit Evropian*.

Tryezat Tematike:

Në bazë të shtatë fushave sektoriale, Sekretariati do të organizojë punën në këto *Tryeza Tematike* (anglisht. *Thematic Round Tables – TRT*). Në kuadër të këtyre *Tryezave Tematike* do të angazhohen dhe kontribuojnë zyrtarë të nivelit menaxherial të strukturave të Qeverisë së Kosovës përgjegjëse për fushat e lartpërmendura, pastaj deputetë të përzgjedhur të Kuvendit (nga partitë në qeverisje dhe ato në opozitë) të cilët kanë ekspertizë në këto fusha dhe janë anëtarë të komisioneve përkatëse funksionale të Kuvendit, autoritete lokale me interes në këtë fushë, agjenci të pavarura, përfaqësues të komunitetit të biznesit (përkatësisht asociacione të bizneseve vendore dhe atyre të huaja që funksionojnë në Kosovë), asociacioneve relevante profesionale, shoqërisë civile, komunitetit akademik (përkatësisht ekspertë të mirënjohur vendorë të fushave relevante), si dhe një numër përfaqësuesish të organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve që fokusohen në fushëveprimin e *Tryezave Tematike*.

Përshkrim i Shkurtë Përmbajtjesor i Tryezave Tematike:

Tryeza Tematike 1, për Reformën e Administratës Publike, do të mbulojë çështjet që kanë të bëjnë me përpjekjet e vendit në drejtim të zhvillimit të reformave në administratën publike, në linjë me kërkesat që dalin nga procesi i integritimit evropian. Kështu, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet kapaciteteve të Qeverisë dhe Kuvendit, sidomos për sa i përket zhvillimit të politikave dhe legjislacionit, përfshirë implementimin e tyre. Për më tepër, kjo *Tryeze Tematike* do të mbulojë në mënyrë të hollësishme implementimin e legjislacionit për shërbimin civil, implementimin e Strategjisë për Reformën e Administratës Publike, implementimin e rishikimeve funksionale, sikurse edhe mekanizmat që merren me zhvillimin e kapaciteteve administrative të shërbimit civil.

Fokus i veçantë do t'i kushtohet edhe mekanizmave për sigurimin e integritetit në administratën publike si dhe menaxhimit dhe kontrollit të financave publike. Gjithashtu, kjo *Tryeze Tematike* mbulon edhe zhvillimet që kanë të bëjnë me koordinimin e politikave dhe planifikimin strategjik. Qeverisja lokale do të ketë vend të veçantë gjatë diskutimeve që do të zhvilloj kjo *Tryeze*.

Tryeza Tematike 2, për Drejtësi, Liri dhe Siguri, do të mbulojë çështjet që kanë të bëjnë me kriteret politike si ato të fushës së reformave gjyqësore dhe sistemit të drejtësisë, sistemit zgjedhor, politikave anti-korrupsion me theks të veçantë në kornizën ligjore dhe mekanizmat institucional për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni. Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve është prej temave me shtrirje të gjerë që do të diskutohen në kësaj *Tryeze Tematike*.

Në kuadër të kapitullit të Standardeve Evropiane, punët e brendshme dhe fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve institucionale për luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit zënë një hapësirë të veçantë në kuadër të diskutimeve që do të zhvillohen në këtë *Tryezë*. Këtyre aspekteve do t'ju kushtohet konsideratë e veçantë duke parasysh se një numër i madh i kritereve që të rrjedhin nga udhërrëfyesi për liberalizim të vizave i takojnë çështjeve që

kanë të bëjnë me politikat e migracionit, bashkëpunimit institucional për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin, sigurinë e dokumenteve civile, menaxhimit të kufijve, dhe fushat e bashkëpunimit me organizatat Evropiane dhe ndërkombëtare për siguri dhe zbatim të ligjit si dhe zbatimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Tryeza Tematike 3, për Ekonomi, Financat dhe Statistika, do të shqyrtoj kornizën legislative dhe institucionale si dhe kapacitetet implementuese në fushat e kësaj tryeze. Më saktësisht diskutimi në këtë *Tryezë Tematike* do të mbulojë çështjet duke filluar nga makroekonomia e deri te menaxhimi i financave publike, statistikave dhe ndërmarrjet shoqërore dhe publike. *Tryeza* do të fillojë me stabilitetin makrofinanciar ku përveç tjerash do të përfshihen edhe marrëdhëniet me Fondin Monetarë Ndërkombëtarë dhe do të pasoj me analizimin e politikave monetare dhe ekonomike. Financat publike në aspektin e planifikimit buxhetorë, të hyrat dhe shpenzimet do të jenë fusha kyçe të kësaj *Tryeze*. Përveç kësaj, analiza e mekanizmave të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit do të kompletojnë fushën e menaxhimit të financave publike dhe do të ofrojnë pasqyrë më të plotë rreth gjendjes ekzistuese dhe nevojave për avancim në procesin e anëtarësimit në BE. Një fushë tjetër e rëndësishme në aspektin e financave që do të mbulohet nga kjo *Tryeze Tematike* është edhe sektori i shërbimeve financiare ku do të përfshihen sfidat dhe nevojat e sektorit bankar, sektorit të sigurimeve dhe fondit pensional.

Dy aspektet e fundit që do të shqyrtojnë kjo *Tryezë* përfshijnë konstatimin e gjendjes në fushën e statistikave si ato demografike (përfshirë regjistrimin e popullsisë dhe banesave), ekonomike, bujqësore, si dhe në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve publike dhe privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore.

Tryeza Tematike 4, për Tregti, Industri, Dogana, Tatime, Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, dhe Mbrojtjen e Konsumatorit dhe atë Shëndetësore, do të mbulojë një numër fushash specifike të politikave të rregulluar më së shumti me legjislacion të BE-së (*Acquis*), por gjithashtu shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Diskutimi në këtë *Tryeze Tematike* do të fillojë me fushën e tregtisë, e cila do të përfshijë tregtinë me BE-në, me vendet fqinje (në kuadër të CEFTA-së), si dhe tregtinë bilaterale me vende të tjera. Përveç diskutimit të bilancit tregtar të Kosovës në raport me këto tregje, dhe identifikimit të mënyrave për përmirësimin e tij në favor të tregut të Kosovës, kjo *Tryezë Tematike* gjithashtu do të fokusohet në ndërlidhjen në mes të tregtisë dhe punësimit, investimet e jashtme dhe procesit e kërkesave në vendosjen e marrëdhënieve me Organizatën Botërore të Tregtisë.

Një komponent tjetër e punës së kësaj *Tryeze Tematike* do të jetë fusha e industrisë dhe ajo Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (NVM), përkatësisht në politikat kombëtare strategjike për zhvillimin e industrisë dhe NVM-ve dhe përmirësimin e mjedisit e të bërit biznes. Komponenti i tretë do të fokusohet në zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut dhe kapacitetin e ekonomisë së Kosovës për të përballuar konkurrencën e forcave të tregut në BE, ku përfshihen kriteret e hyrjes dhe daljes nga tregu të akterëve të tregut, sistemin rregullativ, kapitalin njerëzor dhe fizik, si dhe strukturën sektoriale dhe atë të ndërmarrjeve në treg.

Pjesa më e madhe e punës do të fokusohet në fushën e tregut të brendshëm, përkatësisht në 'Katër Liritë' e mirënjohura të standardeve evropiane (lëvizjen e lirë të mallrave, të fuqisë punëtore, lirinë e ofrimit të shërbimeve përtej kufijve dhe lëvizjen e lirë të kapitalit), pastaj në prokurimin publik (shikuar nga perspektiva e përfshirjes në të forcave të tregut dhe ndikimit të

tij në to), rregullativën për kompani, të drejtat pronësore intelektuale dhe industriale, si dhe në politikat e konkurrencës, mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbrojtjes shëndetësore të konsumatorëve si aktorë të tregut të brendshëm të vendit. Komponenti i fundit në punën e kësaj *Tryeze Tematike* do të fokusohet në fushën e doganave dhe taksave.

Tryeza Tematike 5: Inovacioni, Shoqëria Informative, Politikat Sociale dhe Shëndetësore do të diskutoj dhe analizoj kornizën e politikave, legjislacionit ekzistues, kornizën institucionale dhe kapacitetet implementuese në fushat përkatëse të cilat janë pjesë e kësaj tryeze. Kjo *Tryezë Tematike* do të fokusohet në procesin reformues të arsimit në Kosovë, respektivisht masave të ndërmarra në procesin e implementimit të Strategjisë së Arsimit 2010-2016, si në aspektin e miratimit të legjislacionit përkatës po ashtu edhe në aspektin e kapaciteteve implementuese dhe sigurimit të cilësisë në arsim. Theks i veçantë në këtë fushë do t'i kushtohet edhe implementimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe Arsimit dhe Aftësisimit Profesional. Në fushën e Shkencës dhe Kërkimeve, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet Programit Kombëtar të Kërkimeve, shfrytëzimi i resurseve aktuale dhe ngritja e kapaciteteve kërkimore si dhe përfitimi nga Programet Kornizë të BE-se në fushën e kërkimeve.

Në fushën e punësimit dhe politikave sociale, theks i veçantë do t'i kushtohet implementimit të Ligjit të Punës dhe çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të punës, shëndeti dhe siguria në punë, respektivisht procesi i harmonizimit me standardet e BE-së. Me fokus të veçantë do të diskutohen politikat aktive të punësimit të Kosovës dhe shërbimet publike të aftësisimit profesional, si instrumente të rëndësishme për uljen e papunësisë dhe varfërisë. Politikat përkatëse dhe masat e ndërmarra për promovimin e punësimit për të rinjtë, e cila përbën pjesën më të madhe të të papunëve, si dhe pjesëmarrja e rinisë kosovare në programet e rinisë së BE-së, do të jenë gjithashtu tema kyçe. Politikat në fushën e krijimtarisë kulturore dhe promovimit kulturor, gjithashtu do të jenë pjesë e diskutimeve të kësaj *Tryeze*.

Sa i përket përfshirjes dhe mbrojtjes sociale do të diskutohen skemat e ndryshme të mbrojtjes sociale dhe posaçërisht implementimi i politikave aktive për këto skema. Do tu kushtohet vëmendje faktorëve të përjashtimit social në Kosovë dhe kriteret e definimit të përjashtimit social. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet gjithashtu personave me aftësi të kufizuara, në aspektin e ofrimit të shërbimeve të duhura sociale. Në fushën e politikave shëndetësore me fokus të veçantë do të diskutohet implementimi i Strategjisë Shëndetësore 2009-2014, masave të ndërmarra për ofrimin e shërbimeve më kualitative shëndetësore në të gjitha nivelet, sigurimin shëndetësor dhe financimin e shëndetësisë në përgjithësi. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe ofrimit të shërbimeve të duhura të shëndetit mendor duke përfshirë edhe trajtimin e personave të varur nga substancat narkotike. Kjo *Tryezë* do të diskutoj edhe politikat, legjislacionin ekzistues dhe implementimin e masave në fushën e shoqërisë informative, komunikimeve elektronike & teknologjisë informative dhe politikave audiovizuale, si fushë e rëndësishme e integritit social, qarkullimit të informacionit dhe shfrytëzimit të shoqërisë informative në aspektin e inovacionit social.

Tryeza Tematike 6, për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal. Kjo *Tryezë* do të analizojë gjendjen ekzistuese në fushat e lartpërmendura duke shqyrtuar legjislacionin ekzistues dhe nivelin e harmonizimit me legjislacionin e BE, dokumentet strategjike si dhe kapacitetet administrative dhe financiare për t'i zbatuar ato. Sa i përket mjedisit fokus kryesor do të jetë në analizimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit si dhe masave të

ndërmarrja për të parandaluar ndotjen. Çështjet kyçe që do të trajtohen nga kjo tryezë përfshijnë çështje si menaxhimi i mbeturinave, kualiteti i ajrit dhe ujit, niveli dhe kontrolli i ndotjes, mbrojtja e natyrës, si dhe ndryshimet klimatike.

Sa i përket fushës së transportit, do të analizohet gjendja e përgjithshme duke përfshirë progresin e arritur në zbatimin e marrëveshjeve regjionale (si ajo mbi themelimin e Observatorit Regjional të Transportit në Evropën Juglindore SEETO si dhe marrëveshjen mbi hapësirën e përbashkët ajrore ECAAA) si dhe zbatimin e marrëveshjeve bilaterale me vendet fqinje. Kjo tryezë do të ketë fokus kryesor transportin rrugor duke përfshirë këtu sigurinë në rrugë dhe masat që janë ndërmarrë në këtë aspekt duke përfshirë edhe infrastrukturën ekzistuese dhe nevojën për investime. Gjithashtu do të analizohet gjendja ekzistuese sa i përket formave tjera të transportit duke përfshirë këtu transportin hekurudhor dhe transportin ajror dhe nivelin e harmonizimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Në fushën e energjisë do të shqyrtohet niveli i zbatimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Do të analizohet gjendja ekzistuese në furnizimin me energji elektrike si dhe hapat që janë ndërmarrë për të përmirësuar gjendjen, duke përfshirë këtu edhe mbylljen e Termocentralit "Kosova A" dhe projektin për ndërtimin e termocentralit të ri. Sa i përket zhvillimit regjional fokus kryesor do të ketë diagnostikimi i kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe lokal për të stimuluar zhvillim ekonomik. Më saktësisht do të vlerësohet kapaciteti institucional në menaxhimin financiar, zbatimin e programeve (duke përfshirë edhe zbatimin e programeve të IPA) si dhe monitorimin dhe vlerësimin e tyre. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet funksionimit të Qendrave për Zhvillim Regjional. Për shkak se zhvillimi i fushave të cilat do të trajtohen në këtë tryezë janë çështje që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të shoqërisë, rëndësi e veçantë do ti kushtohet pjesëmarrjes dhe konsultimit me një spektër sa më të gjerë të shoqërisë. Do të synohet arritja e konsensusit sidomos në çështjet që ndikojnë drejtpërdrejtë me mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë sikurse janë masat dhe veprimet për mbrojtjen e mjedisit, mundësimin e transportit të sigurt dhe infrastrukturës, gjetjen e metodave alternative për furnizimin e rregullt me energji duke mos ndikuar në ndotjen e ambientit, si dhe masat për zhvillim dhe përmirësim të kualitetit të jetës.

Tryeza Tematike 7 për Bujqësi, Peshkatari, Pylltari, Siguri të Ushqimit dhe Zhvillim Rural do të mbulojë çështjet që kanë të bëjnë me progresin dhe përpjekjet e vendit për të avancuar në këto fusha, veçanërisht duke u bazuar në kërkesat për integrim në Bashkimin Evropian. Kjo synohet të arrihet përmes mekanizmit të zhvillimit të konsensusit në shtjellimin e temave të lartë-cekura, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara në proces, por duke u fokusuar në institucionet qeveritare qendrore dhe lokale, në organizatat e shoqërisë civile si dhe në organizatat ndërkombëtare.

Fillimisht kjo *Tryeze Tematike* do të mbulojë fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Theks i veçantë do t'i kushtohet strukturës legjislative dhe kapaciteteve administrative. Përveç kësaj, kjo *Tryeze Tematike* do të trajtoj edhe shumë çështje tjera të rëndësishme për fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të cilat do të përfshijnë, por nuk do të jenë të kufizuara në, politikat e prodhimit dhe mbështetjes financiare, politikat e zhvillimit rural dhe zhvillimit të cilësisë, të ardhurat e fermerëve dhe krijimin e standardeve të përshtatshme dhe të favorshme për tregun e Kosovës.

Përveç fushës së Sigurisë së Ushqimit, kjo *Tryeze Tematike* si temë të diskutimeve do të ketë edhe politikën e Veterinarisë dhe Fitonanitarisë. Kjo do të përfshijë zbatimin e standardeve shëndetësore, masat higjienike, mbrojtjen e konsumatorëve, vendosjen e produkteve në treg, cilësinë e produkteve dhe çështjet ilegale të ndërlidhura me specifikat e këtyre fushave. Gjithashtu, në këtë *Tryeze Tematike* do të trajtohen edhe fusha e Pylltarisë dhe Peshkatarisë. Më konkretisht temat e diskutimit do të përfshijnë çështjet e menaxhimit dhe mbrojtjes së pylltarisë, aktivitetet e peshkimit dhe gjuetisë, mbështetja financiare, trajtimi institucional dhe çështje të tjera relevante për shoqërinë në përgjithësi.

Si përfundim, kjo *Tryeze Tematike* është më së shumti e interesuar në kapacitetet institucionale si dhe në implementimin e kornizave ligjore dhe të politikave në fushat përkatëse, gjithmonë duke respektuar rregullat e legjislacionit dhe politikave të BE.